



## Periodik mujor Nr. 169 Qershor 2023



**Në  
këtë  
periodik  
do të lexoni:**

**IAIS miraton raportin e vlerësimit për AMF,  
përparim domethënës në Parimet Themelore  
në Sigurime (ICP)**

3

**VËSHTRIM  
MBI TREGJET**

**Tregu i Sigurimeve, Janar- Maj 2023**

5

**ZHVILLIME TË TJERA**

**BOTIME  
PROFESIONALE**

6-9

**INFORMACIONE  
NDËRKOMBËTARE**

10-13

## IAIS miraton raportin e vlerësimit për AMF, përparim domethënës në Parimet Themelore në Sigurime (ICP)



Seattle, SHBA, qershor 2023 – AMF pjesëmarrëse në mbledhjen e IAIS

Komiteti Ekzekutiv i Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) miratoi raportin përfundimtar të vlerësimit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, në lidhje me përputhshmërinë me Parimet Themelore në Sigurime (ICP). Gjatë vitit 2022, Autoriteti iu nënshtrua një procesi rigoroz vlerësimi në lidhje me përputhshmërinë e standardeve dhe praktikave të AMF-së me Parimet Themelore në Sigurime (ICP).

Ky proces vjen pas atij të vitit 2014, të kryer nga FMN dhe Banka Botërore, në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), rekomandimet e të cilit u reflektuan në miratimin e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe ndryshimeve të ndërmarra në Ligjin nr. 9576, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Procesi i vlerësimit të përputhshmërisë me ICP-të u krye nga anëtarë të IAIS-it, bazuar në Programin e Vlerësimit të Anëtarit dhe përfshiu aspektin ligjor e rregullator, pavarësinë institucionale, procedurat e licencimit, praktikat mbikëqyrëse dhe ato të vlerësimit të rrezikut, mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit, etj.

Në raportin përfundimtar të vlerësimit, të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të IAIS-it dhe të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv, rezultoi një nivel i lartë i përputhshmërisë me ICP-të, ku nga 24 parime bazë, 10 prej tyre rezultuan plotësisht të përputhura dhe 12 të tjera me një nivel të lartë përputhshmërie. Ky vlerësim përbën një avancim të ndjeshëm kundrejt rezultateve të vlerësimit të vitit 2014, ku vetëm një parim bazë rezultoi plotësisht i përputhur me standardet ndërkombëtare. Sipas përlllogaritjeve, rezultoi se mesatarja e ponderuar e përputhshmërisë së ICP-ve është rritur në 77.9%, krahasuar me 47.4% që ishte kjo mesatare në vlerësimin e bërë në vitin 2014.

Vijon...

Në raportin përfundimtar të vlerësimit, të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të IAIS-it dhe të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv, rezultoi një nivel i lartë i përputhshmërisë me ICP-të

## **IAIS miraton raportin e vlerësimit për AMF, përparim domethënës në Parimet Themelore në Sigurime (ICP)**



... Vizion

Fushat ku është konstatuar progres i ndjeshëm nga Grupi i Vlerësimit të IAIS janë kuadri ligjor dhe ai mbikëqyrës, pavarësia institucionale e AMF, praktikat e licencimit dhe përshtatshmërisë së subjekteve, kërkesat për qeverisjen dhe menaxhimin e riskut, risigurimi, mbikëqyrja efektive ndërkufitare, kuadri ligjor kundër pastrimit të parave në sektorin e sigurimeve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i informacionit, si edhe transparenca.

Në linjë me rekomandimet e raportit, Autoriteti do të vijojë punën në drejtim të rishikimit të kuadrit ligjor e rregullator në fushën e sigurimeve, si edhe përmirësimit të atyre aspekteve ku nevojitet avancim i mëtejshëm me synim përafrimin me Parimet Themelore në Sigurime.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar – Maj 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar-maj 2023 kapën vlerën 8,959 milionë lekë, ose 15.29% më shumë se në janar-maj 2022. Gjatë muajit janar-maj 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 505,098 me një rritje prej 13.36% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.97% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 7.93% dhe risigurimi 0.102%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 46.50% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 53.50% të totalit të tregut.

Gjatë muajit janar-maj 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,706 milionë lekë, ose 0.32% më pak se në muajin janar-maj 2022. Kjo ka ardhur kryesisht për shkak të efektit të sigurimit të pronës, si pasojë e përfundimit të pagesave të dëmeve të ngjarjeve të tërmetit të vitit 2019.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për muajin janar-maj 2023 kapën vlerën 1,953 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 9.44% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Maj 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë muajit janar-maj 2023 arritën rreth 4,793 milionë lekë, ose 8.12% më shumë se në muajin janar-maj 2022.

# ZHVILLIME TË TJERA

## Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së në aktivitetin “Financing Sustainable Development in Albania”



Tiranë, 26 qershor 2023 – Aktiviteti: “Financimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri”

Një ndër objektivat kryesorë të AMF-së është edhe avancimi i agjendës drejt financimeve të gjelbra dhe të qendrueshme.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, mori pjesë në aktivitetin “Financing Sustainable Development in Albania”, të organizuar nga UNDP (United Nations Development Programme), në kuadër të programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Strategic Policy Options for SDG Financing”.

Në sesionin e dytë të këtij aktiviteti z. Mete theksoi se një ndër objektivat kryesorë të AMF-së është edhe avancimi i agjendës drejt financimeve të gjelbra dhe të qendrueshme. Suksesi i këtij objektivi varet shumë nga përfshirja dhe angazhimi i të gjithë aktorëve së bashku, pasi riorientimi i kapitalit privat drejt investimeve të qendrueshme kërkon një ndryshim të mendësisë në mënyrën se si funksionon sistemi financiar. Përpjekjet e Autoritetit synojnë bashkërendimin dhe koordinimin me të gjithë aktorët, me qëllim vendosjen e rregullave për taksonominë, në linjë me praktikatat evropiane, si edhe nxitjen dhe promovimin e emetimit të obligacioneve të gjelbra të pushtetit lokal, apo të korporatave shtetërore, në linjë edhe me Dokumentin Politik “Për Krijimin e një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”.

AMF ka ndërmarrë një harmonizim të kuadrit ligjor në tregjet financiare jobankare, për përfshirjen në bazën ligjore dhe rregullatore të kërkesave për financimin e zhvillimit të qendrueshëm dhe promovimin e nevojës për orientim të kapitalit drejt investimeve të qendrueshme. Në linjë me direktivat evropiane, aktet e reja kanë diversifikuar shërbimet e investimit, si edhe kanë zgjeruar mundësitë e ndërlidhjes me tregjet ndërkombëtare.





## **ESMA lançon “Strategjinë e të Dhënave” për pesë vitet e ardhshme**

Autoriteti Evropian i Letrave me Vlerë dhe Tregjet (ESMA), rregullatori dhe mbikëqyrësi i tregjeve financiare të BE-së, ka publikuar “Strategjinë e të Dhënave” për 2023-2028.

Gjatë pesë viteve të ardhshme, ESMA do të punojë për të lehtësuar përdorimin e teknologjive të reja lidhur me të dhënat, për të reduktuar kostot e pajtueshmërisë së raportimit nga subjektet e rregulluara, për të mundësuar përdorimin efektiv të të dhënave si në nivel BE ashtu edhe në nivel kombëtar; dhe që t'i bëjë të dhënat më gjerësisht të disponueshme për publikun.

Verena Ross, kryetare e ESMA-s, theksoi kënaqësinë për prezantimin e “Strategjisë së të Dhënave”, përmes së cilës ESMA do të forcojë rolin e saj si mbikëqyrës dhe si qendër e të dhënave dhe informacionit në BE. “Ne duam të kontribuojmë në zvogëlimin e barrës së pajtueshmërisë për kompanitë dhe të lehtësojmë raportimin e të dhënave me anë të rritjes së standardizimit dhe përdorimit të zgjidhjeve moderne të TI-së përgjatë procesit të raportimit dhe të gjithë ciklit jetësor të të dhënave. Qëllimi ynë është të sigurojmë akses më të lehtë në të dhënat financiare, si përmes ndarjes së zgjeruar të të dhënave me autoritetet në të gjithë BE-në dhe në nivel kombëtar. Iniciativa të tilla si ESAP do të ofrojnë akses në të dhënat financiare në tregun më të gjerë, duke përfshirë investitorët me pakicë.”

Me këtë projekt për të dhënat, gjatë pesë viteve të ardhshme, ESMA synon të:

- Bëhet një qendër e përmirësuar e të dhënave, duke forcuar ESMA-n si qendër e të dhënave për tregjet e letrave me vlerë të BE-së, duke u fokusuar në përmirësimin e aksesit të të dhënave dhe informacionit, ndërveprueshmërinë dhe përdorshmërinë, dhe arritjen e sinergjive dhe ekonomive të shkallës;

Vijon ...

ESMA do të punojë për të lehtësuar përdorimin e teknologjive të reja lidhur me të dhënat, për të reduktuar kostot e pajtueshmërisë së raportimit nga subjektet e rregulluara, për të mundësuar përdorimin efektiv të të dhënave

## ESMA lançon Strategjinë e të Dhënave për pesë vitet e ardhshme



...Vijon

- Sigurojë akses në të dhënat me interes publik, duke kontribuar në ofrimin e informacionit lehtësisht të aksesueshëm dhe të përdorshëm për pjesëmarrësit e tregut, duke përfshirë investitorët me pakicë, në formate të lexueshme nga makineri dhe nëpërmjet kërkimit dhe ndërfaqeve analitike miqësore për përdoruesit;
- Promovojë mbikëqyrjen e drejtuar nga të dhënat, duke mundësuar mbikëqyrje moderne, të zgjuar dhe efektive të drejtuar nga të dhënat nga zhvillimet e përbashkëta dhe përdorimi i teknologjive të reja;
- Rrisë bashkëpunimit e të dhënave, duke arritur në standardizimin e cilësisë dhe ripërdorimin më të mirë të të dhënave si edhe promovimin e adoptimit të teknologjive inovative;
- Prodhon rezultate efikase të politikës së të dhënave, duke reduktuar barrën e pajtueshmërisë për entitetet raportuese duke reduktuar kërkesat e dyfishta dhe jokonsistente, duke optimizuar rrjedhat e raportimit, ndarjen efektive dhe efikase të të dhënave dhe duke shfrytëzuar teknologjitë në zhvillim; dhe
- Lehtësojë përdorimin sistematik të të dhënave, duke krijuar procese, metodologji dhe mjete që mundësojnë përdorimin sistematik të të dhënave për zhvillimin e politikave të bazuara në dëshmi, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut.

Strategjia e ESMA-s mbi të dhënat gjendet në:

file:///F:/Materiale/Downloads/ESMA50-157-3404\_ESMA\_Data\_Strategy\_2023-2028.pdf



## “Java Botërore e Investitorit” e IOSCO-s do të fokusohet në Qëndrueshmërinë e Investitorëve, Kripto-Assetet dhe Financat e Qëndrueshme



IOSCO do të zhvillojë javën e saj të shtatë vjetore botërore të investitorëve nga 2 deri më 8 tetor 2023. Megjithatë rregullatorët nga juridiksionet pjesëmarrëse mund të zgjedhin çdo javë tjetër në tetor apo nëntor 2023 për të kryer aktivitetet e tyre që lidhen me WIW.

Siç pasqyrohet në raportin publik të IOSCO-s për vitin 2022, i cili u publikua në fund të muajit qershor, vazhdon të rritet pjesëmarrja e juridiksioneve të ndryshme në këtë javë me mjaft aktivitetet, si nga rajonet e zhvilluara ashtu edhe në ato të tregjeve në zhvillim. Pavarësisht nga kushtet sfiduese të përjetuara gjatë pandemisë globale, numri i juridiksioneve dhe palëve të interesuara për të marrë pjesë në WIW u rrit në vitet 2020, 2021 dhe 2022, duke vënë në pah nevojën për edukim financiar për të rritur mbrojtjen e investitorëve me pakicë në mbarë botën.

Këtë vit, fushata WIW do të fokusohet në tre tema kryesore:

- Qëndrueshmëria e Investitorëve;
- Kripto Asetet; si edhe
- Financat e Qëndrueshme.

Këto janë temat të cilat Bordi i IOSCO-s i ka identifikuar si veçanërisht të rëndësishme duke pasur parasysh kushtet aktuale dhe të pritshme të tregut global. Tema të tjera që do të zhvillohen gjatë kësaj jave lidhen me parandalimin e mashtrimeve, bazat e investimit, teknologjia dhe financat digjitale.

Z. Jean-Paul Servais, Kryetar i Bordit të IOSCO-s dhe Kryetar i Autoritetit të Shërbimeve Financiare dhe Tregjeve, të Belgjikës tha: “Mbrojtja e investitorëve është një objektivi kyç i IOSCO-s. Rregullatorët e letrave me vlerë përdorin mjete të ndryshme për të promovuar dhe përmirësuar mbrojtjen e investitorëve, duke përfshirë politikat, mbikëqyrjen, zbatimin dhe edukimin financiar. Gjatë pandemisë globale, investitorët me pakicë u përballën me rreziqe të reja dhe më të mëdha; disa nga këto rreziqe mund të vazhdojnë në të ardhmen ose të zhvillohen. Si përgjigje, Programi i Punës i IOSCO-s 2023-2024 do të vazhdojë të mbështesë edukimin e investitorëve si një shtyllë kritike e mbrojtjes së investitorëve, së bashku me masat e tjera që synojnë luftën ndaj mashtrimit të tregut me pakicë, promovimin e besimit të investitorëve, përfshirjen financiare dhe mbrojtjen e interesave të investitorëve.

---

IOSCO do të zhvillojë javën e saj të shtatë vjetore botërore të investitorëve nga 2 deri më 8 tetor 2023

## BOSNJE-HERCEGOVINA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave tremujore të publikuara nga rregullatori i sigurimeve në Bosnje-Hercegovinë (BiH), AZOBiH, në fund të marsit 2023, tregu i sigurimeve në BiH arriti në 117.27 milionë euro, rreth 229.35 milionë BAM, duke shënuar një rritje me 9.32% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës, për të njëjtën periudhë u rritën me 10.64% duke arritur në 92.46 milionë euro, ndërsa primet në sigurimin e Jetës u rritën me 4.67%, duke arritur në 24.81 milionë euro. Nga nënklasat e sigurimit të Jo-Jetës, 12.61 milionë euro i korrespondojnë sigurimit të pronës dhe 63.18 milionë euro sigurimit motorik.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguresit që operojnë në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës u rrit me 10.59% duke arritur në 82.98 milionë euro, ndërsa siguresit me bazë në Republikën Serbe të Bosnjës realizuan 34.29 milionë euro, duke u rritur me 6.36% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## ÇEKI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas Shoqatës Profesionale të sigurimeve në Çeki, CAP, tregu i sigurimeve në vend në fund të marsit 2023 arriti në rreth 42.9 miliardë CZK ose rreth 1.8 miliardë euro duke shënuar rritje me 5.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e sigurimit të Jetës u rritën me 2.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë duke arritur në 13 miliardë CZK ose rreth 553 milionë euro. Numri i përgjithshëm i kontratave të sigurimit të Jetës vazhdon të ulet: "Nga viti në vit janë 1.1% më pak. Aktualisht janë 4,855,000 kontrata aktive", theksuan përfaqësuesit e CAP.

Në sigurimet e Jo-Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto arriti në 29.9 miliardë CZK ose rreth 1.3 miliardë euro, duke u rritur me 6.8% në tremujorin e parë 2023 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimi motorik vazhdon të jetë dominues, duke zënë aktualisht 51% të sigurimeve të Jo-Jetës. Vlera e primeve të shkruara bruto të sigurimit MTPL arriti në 7.7 miliardë CZK, ose 5.4% më shumë krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Edhe primet në sigurimin Kasko u rritën me 11.6% në shumën prej 7.5 miliardë CZK. Përfaqësuesit e CAP përmendën se rritjet janë "pjesërisht të mbështetura nga portofoli gjithnjë në rritje i automjeteve të siguruara".

## **GREQI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave paraprake të tremujorit të parë 2023, të publikuara nga Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, HAIC, në fund të muajit mars, tregu i sigurimeve në Greqi arriti në 1.23 miliardë euro, 6.8% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimet e Jetës u rritën me 3.6% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 577.8 milionë euro. Ndërsa nënklasat e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me rreth 10% duke arritur në 656.5 milionë euro.

Rezultatet e tregut të tremujorit të parë 2023 të publikuara nga HAIC përfshijnë shifrat për 49 sipërmarrje sigurimesh, nga të cilat 43 ishin aktive në sigurimet e Jo-Jetës dhe 16 në sigurimet e Jetës.

## **HUNGARI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave të tremujorit të parë të publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, vëllimi i primeve të shkruara bruto në fund të tremujorit të parë 2023 të raportuar nga siguresit hungarezë arriti në 421.71 miliardë HUF ose rreth 1.10 miliardë euro. Ky tregues shënon rritje prej 6.57% më shumë në krahasim të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Segmenti i sigurimit të Jetës zë 35.85% dhe sigurimet e Jo-Jetës zënë 64.15% të vëllimit total të primeve.

Për sa i përket dëmeve, totali i dëmeve të shkaktuara (duke përfshirë pagesat dhe ndryshimin e rezervave) u rrit me 1.81% duke arritur në 193.81 miliardë HUF. Dëmet e shkaktuara në sigurimit të Jetës u rritën duke arritur në 112.33 miliardë HUF, ndërsa për sigurimet e Jo-Jetës, dëmet arritën në 81.48 miliardë HUF.

Në fund të muajit mars 2023, në tregun hungarez të sigurimeve ishin aktive 22 sigures: 4 sigures të specializuar të Jetës, 9 sigures të Jo-Jetës dhe 9 sigures të përbërë.



## KOSOVA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, BQK, tregu i sigurimeve në Kosovë në fund të tremujorit të parë 2023 arriti në 34.2 milionë euro, ose 14.8% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sipas publikimit të BQK, primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 1.8 milionë euro, ndërsa ato të Jo-Jetës u rritën me 16.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 32.4 milionë euro. Sigurimi i detyrueshëm motorik zinte 16.2 milionë euro, policat kufitare 1.1 milionë euro dhe 15.1 milionë euro ishin primet e shkruara për klasat e tjera vullnetare.

Në tregun e sigurimeve në Kosovë veprojnë 12 shoqëri sigurimi, nga të cilët shtatë janë në pronësi të huaj. Asetet e zotëruara nga kompanitë e sigurimeve kosovare u rritën në fund të tremujorit të parë 2023, duke arritur në 289.9 milionë euro nga 249.0 milionë euro që ishin në të njëjtën periudhë një vit më parë.

## POLONI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave tremujore të publikuara nga Autoriteti Polak i Mbikëqyrjes Financiare, KNF, tregu polak i sigurimeve në tremujorin e parë 2023 raportoi një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 20.12 miliardë PLN ose rreth 4.30 miliardë euro. Kjo shifër përfaqëson një rritje prej 10.89% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Për të njëjtën periudhë kohore, dëmet e paguara nga siguruesit vendas u ulën me 2.46% në terma vjetore duke arritur në 11.25 miliardë PLN ose rreth 2.40 miliardë euro, nga 11.53 miliardë PLN një vit më parë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rrit në 14.59 miliardë PLN, ose rreth 3.12 miliardë euro, në tremujorin e parë të vitit 2023, duke shënuar rritje me 13.13% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Segmenti i sigurimit të Jetës u rrit me 5.38% duke arritur në 5.53 miliardë PLN ose 1.18 miliardë euro.

## TURQI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB, vëllimi i primeve të shkruara bruto, të realizuara në tregun e sigurimit të Turqisë gjatë periudhës janar-mars 2023 u rrit në monedhën vendase me 140.86% duke arritur në 103.79 miliardë TRY ose 4.98 miliardë euro.

Primet e sigurimit të Jo-Jetës, për tremujorin e parë të vitit 2023, u rritën me 146.50% në terma nominale, duke arritur në 91.94 miliardë TRY ose 4.41 miliardë euro. Primet e sigurimit të Jetës u rritën me 104.54% në vit në 11.85 miliardë TRY ose rreth 568.52 milionë euro.



Për informacion të mëtejshëm  
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)